



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2026

VENDIM

Nr. 13, datë 30.04.2026

PËR
MIRATIMIN E “PASQYRAVE FINANCIARE TË
“FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME”
PËR TREMUJORIN E PARË TË MBYLLUR MË 31 MARS 2026”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1” të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, nenit 71, pika 2, të nenit 73, pika 1, dhe të nenit 79 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenin 15, pika 1 dhe pika 5 dhe të nenit 18 pika 1 të Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të miratuar me Vendimi të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 3.10.2017, të ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të vendimit nr. 31 datë 10.10.2025 “Për caktimin e Z. Martin Blushi, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”, të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Pasqyrave financiare të “Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” për tremujorin e parë të mbyllur më 31 mars 2026”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi në Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
3. Ngarkohen Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës të Riskut për zbatimin e këtij vendimi.





4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Tianda Kaçi

Sekretare

